



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.5/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Violeta Husaj Rugova, kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjekti Politik Partia e Ashkalive për Integrim, PAI, paraqitur kundër Njoftimit për pezullim të certifikimit, nga Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, të datës 20.08.2025, për shkak të pezullimit të certifikimit të Subjektit Politik Partia e Ashkalive për Integrim, PAI, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë: 27.08.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar, ankesa e Subjekti Politik Partia e Ashkalive për Integrim, PAI, paraqitur kundër Njoftimit për pezullim të certifikimit, nga Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, të datës 20.08.2025, për shkak të pezullimit të certifikimit të Subjektit Politik Partia e Ashkalive për Integrim, PAI, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 25.08.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Partia e Ashkalive për Integrim, PAI, të paraqitur kundër Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, në të cilën pretendohet se KQZ ka bërë përjashtimin e subjektit politik nga përfaqësimi demokratik për shkak të mos pagimit të obligimit financiar në shumën prej 1 000 euro, ndaj PZAP-it.

Më tej në ankesë theksohet se Subjekti Politik PAI, gjendet në situatë të rëndë ekonomike dhe se këto mjete financiare nuk i posedojnë në gjiro llogarinë e saj. Kërkojnë nga PZAP-i që të mundësojnë certifikimin e tyre për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale, duke pretenduar se obligimin financiar do ta kryejnë sa më shpejtë që është e mundur. Në ankesë kanë bashkangjitur raportin financiar të Subjektit Politik PAI, dhe Njoftimin për pezullimin e certifikimit nga ana e KQZ-së.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sqaron se në përputhje me paragrafin 3 të nenit 16 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, partia politike e regjistruar është automatikisht e certifikuar, por duhet të njoftojë Zyrën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga deklarimi i datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës përfundimisht ndryshimi për kryetar të partisë, përfaqësues të autorizuar të partisë, ose përfaqësues financiar të partisë dhe çfarëdo informata të nevojshme lidhur me këso lloj ndryshimesh. Mifëpo pavarësisht të certifikimit të

subjektit politik, për të marrë pjesë në zgjedhje, një parti politike duhet të dorëzojë listën e kandidatëve të cilët duhet të kalojnë nëpër procesin e verifikimit dhe më tutje certifikimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Sa i përket vazhdimsisë së procesit të certifikimit, sipas paragrafit 13 të nenit 16 të LZP, KQZ-ja, me planimin e aplikimit për certifikim nga subjekti politik, përfshi edhe partinë politike të regjistruar, kërkon nga PZAP-ja dhe Zyra të japë konfirmim me shkrim se subjekti politik që aplikon ka paguar plotësisht gjokat në lidhje me cilat do zgjedhje të mëparshme dhe të konfirmojë se nuk ka borxhe tjera të papaguara. Ky paragraf gjithashtu i jep të drejtë KQZ të pezullojë procesin e aplikimit në rast se një subjekt dështon të plotësojë kërkuesat që dalin ky nen.

Më tej në përgjigje të KQZ-së, theksohet se subjekti politik PAI, është parti e regjistruar në KQZ nga data 05.11.2010, dhe është konsideruar automatikisht e certifikuar. Mirëpo duke vepruar në bazë të kërkesave të nenit 16 të LZP, Zyra ka kërkuar nga PZAP konfirmimin e gjokave të papaguara nga subjektet politike me ç'rast PAI, ka rezultuar të ketë një gjokë prej një mijë (1000) euro të papaguar.

Zyra ka informuar partinë në fjalë në lidhje me pamundësinë e vazhimit të procesit të certifikimit duke dërguar një njoftim për pezullim të certifikimit tek personat e autorizuar të kësaj partie, që përfshijnë Kryetarin e partisë dhe personin e autofizuar të partisë, me datën 20 Gusht 2025. Po të njëjtën ditë, Zyra ka pranuar përgjigje nga Kryetari i partisë, Hetem Arifi, se Partia e Ashkalinjëve për Integrim nuk do të marrë pjesë në Zgjedhjet Lokale 2025. Në përgjigje, KQZ-ja, ka bashkangjitur korrespondencën me Subjektin Politik PAI në lidhje me pezullimin e procesit të certifikimit.

PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë të KQZ, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se subjekti politik Partia e Ashkalijve për Integrim-PAI, nuk ka përfunduar të gjithë hapat e aplikimit për certifikim përmes platformës elektronike për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, përfshirë edhe pagesën e gjokës ndaj PZAP-it, ashtu siç parashihet në bazë Nenit 16 të LZP-së, përkatsisht paragrafi 13 ku parashihet se "Çdo dështim në përmbushjen e kërkesave të këtij neni i jep të drejtë KQZ-së të pezullojë procesin e aplikimit. Përveç kërkesave të certifikimit të përcaktuara me dispozitat e cekura më lartë, KQZ-ja, me pranimin e aplikimit për certifikim nga subjekti politik, përfshirë edhe partinë politike të regjistruar, kërkon nga PZAP-ja dhe Zyra të japë konfirmim me shkrim se subjekti politik që aplikon ka paguar plotësisht gjokat në lidhje me cilat do zgjedhje të mëparshme dhe të konfirmojë se nuk ka borxhe tjera të papaguara.

Në bazë të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2024 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të tyre perkatësisht neni 2 ku parashihet Aplikimi për certifikim i subjektit politik dhe kandidatëve të tyre në paragrafi 2 përcakton:-"pas përmbushjes së kërkesave sipas paragrafit 1 të këtij neni partia politike e regjistruar do të jetë automatikisht e certifikuar, përveç nëse Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Prashtresa (PZAP) konfirmon se një parti politike

nuk nuk i ka paguar gjobat e shqiptuara në zgjedhje paraprake apo ndonjë detyrim tjetër, përfshirë këtu edhe gjobat e shqiptuara nga KQZ apo është sanksionuar sipas nenit 15 të Rregullores Nr.01/2024 Regjistrimi dhe Funksionimi i Partive Politike”.

Pretendimi i kandidatit lidhur me përjashtimin e subjektit politik PAI, nga përfaqësimi demokratik përmes pjesëmarrjes në gara për Zgjedhjet Lokale, të cilat do të mbahen me datë 12.10.2025, nuk qëndron, sepse PAI me vendim të KQZ është pezulluar për shkak se nuk ka bërë pagesën e gjobës në shumën prej 1000 euro, e cila gjobë i është shqiptuar nga PZAP-i, për shkeljet në Zgjedhjet paraprake për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura 09 Shkurt 2025, gjë që mos pagesën e gjobës nuk e konteston as vetë subjekti politik në fjalë.

Paneli vlerësoj se me vendimin e ankimuar nuk janë cenuar të drejtat e kandidatit për pjesëmarrje në zgjedhje, sepse me dispozitat imperative ligjore është përcaktuar qartë kush mund të certifikohet për kandidat, kushtet që duhet plotësuar përfshi edhe pasojat për mospagesat e gjobave. Andaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr.5/2025, datë: 27.08.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta HusajRugova

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.